



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 564/1 Prot.

Tiranë, më 17.6.2015

Lënda : Në lidhje me kërkesën për mendim.

Drejtuar: Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

Znj. Milva EKONOMI
Drejtoresh e Përgjithshme e Komanduar

Adresa: Rruga "Sami Frashëri" Nr. 8.

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u njoh me kërkesën tuaj, administruar me nr. 564 prot, datë 08.06.2015, dhe me rrethanat e parashtruara nga ana juaj. Paraprakisht, vlerësojmë angazhimin tuaj në respekt të detyrimeve ligjore dhe në këtë kuadër, në vijim do të gjeni interpretimin ligjor përkatës.

Në nenin 3, pika 1, e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, parashikohet se, "Të dhëna personale është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social".

Në nenin 3/6, të ligjit të mësipërm, përcaktohet termi dhe kuptimi se kush është subjekt i të dhënave personale. Sipas këtij përcaktimi ligjor "Subjekt i të dhënave personale është çdo person fizik, të cilit i përpunohen të dhënat personale".

Në nenin 3/5, të tij, përcaktohet termi dhe kuptimi se kush është subjekt kontrollues. Sipas këtij përcaktimi ligjor "Kontrollues është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj".

Në lidhje me rastin tuaj, vlerësojmë se Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, ka për objekt përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave dhe jo për mbrojtjen e të dhënave të subjekteve kontrolluese (Farmaci), të dhënat e të cilave edhe në zbatim të detyrimeve të tjera ligjore janë aktualisht ose duhet të jenë publike.

Sa i përket publikimit në faqen elektronike të institucionit tuaj, të shumës që rimbursion Fondi për çdo farmaci me të cilën ka lidhur kontratë për rimbursimin e barnave, në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", përgatitja dhe miratimi i programeve të transparencës, është kompetencë e autoritetit publik për të vënë në zbatim një program institucional transparence, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.

Në nenin 4, pika 2, e ligjit të mësipërm parashikohet se "Në përgatitjen e projekt-programit të transparencës, autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik, b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion..."

Gjithashtu në nenin 7, "Kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë", pika 1/ë) *Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë:*

i) listën e kontratave të lidhura;

ii) shumën e kontraktuar;

iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;

iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.

Në këtë kuadër, vlerësojmë se publikimi në faqen elektronike të institucionit tuaj, të shumës që rimbursion Fondi për çdo farmaci me të cilën ka lidhur kontratë për rimbursimin e barnave, është i ligjshëm dhe nuk vjen në kundërshtim me dispozitat që lidhen me të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

